



Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

## **Zgjedhjet Parlamentare**

### **Shqipëri 2013**

**Mësimet e nxjerra nga vëzhguesit e Demokracisë në Veprim**

Qershor 2013

## I. Hyrje

Demokracia në Veprim (DnV) është një rrjet i organizatave jo-qeveritare në Kosovë që ka për qëllim promovimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta përmes vëzhgimit të proceseve zgjedhore, edukimit të votuesve dhe avokimit për reformë zgjedhore.

Me përkrahjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), DnV dërgoi tetë (8) vëzhgues afatshkurtër në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit në Shqipëri. Qëllimi kryesor i vëzhgimit të këtyre zgjedhjeve ishte që të bëhej një analizë e pilot-projekteve për përdorimin e teknologjisë së zgjedhjeve në Shqipëri, si dhe të bëhej një studim fizibiliteti për përdorimin e kësaj teknologjie në të ardhmen në Kosovë. Vëzhguesit janë ndarë në dy grupe, katër vëzhgues në Tiranë ku do të përdorej teknologjia për identifikimin biometrik të votuesve dhe katër të tjerë në Fier ku do të përdorej teknologjia për numërimin e fletëvotimeve.

Gjatë procesit zgjedhor vëzhguesit kanë qenë të lëvizshëm, duke mbuluar mbi 15 qendra të votimit në ditën e zgjedhjeve dhe 6 qendra të numërimit për të vëzhguar pranimin e materialeve, hapjen e kutive dhe numërimin e fletëvotimeve. Vëzhguesit gjithashtu kanë vizituar selitë e Partisë Demoraktike (PD), Partisë Socialiste (PS), Aleancës Kuq e Zi (AKZ), si dhe qendrën e thirrjeve të koalicionit të vëzhguesve vendor, të cilët kishin pasur rreth 700 vëzhgues në qendra të ndryshme të votimit.

Ky nuk është një raport zyrtar i vëzhgimit të zgjedhjeve në Shqipëri, pasi që një vëzhgim i mirëfilltë i procesit zgjedhor kërkon angazhimin e një numri më të madh të vëzhguesve. Përmes këtij raporti, DnV vetëm dëshiron të prezantoj disa mësimë të nxjerra nga ato qendra të votimit dhe të numërimit që ishin të mbuluara. DnV shpreson që këto mësimë të hyjnë në përdorim për akterët të cilët punojnë në reformën zgjedhore në Kosovë në të ardhmen.

## II. Hapja e Votimit

Në shumicën e qendrave të votimit të mbuluara nga monitoruesit e DnV-së, hapja e vendvotimeve ishte bërë në mënyrë të rregullt. Me kohë ishin sjellë dy kuti të votimit, njëra prej tyre përmbante materialet zgjedhore të ndjeshme e cila ishte e lidhur me shiritat e sigurisë, dhe tjetra ishte kutia e zbrazët e votimit ku do të futeshin fletëvotimet. Komisionerët e hapnin kutinë me materiale të ndjeshme, lidhnin shiritat e sigurisë në kutinë e votimit dhe nënshkruanin protokollin për të hapur vendvotimin me kohë (07:00).

Vëzhguesit tanë panë një vendvotim ku hapja u vonua për shkak të gabimeve teknike që kishin bërë komisionerët pa ndonjë qëllim të caktuar. Në qendrën e votimit *Jeronim de Rada* në Tiranë komisionerët e vendvotimit e kishin gabuar kutinë e votimit me kutinë në të cilën silleshin materialet e ndjeshme. Ata i kishin nxjerrë materialet e ndjeshme nga kutia, dhe pastaj kishin vënë shiritat e sigurisë në të njëjtën kuti, e jo në kutinë adekuate ku do të duhej të votohej. Komisionerët kishin mbetur pa shirita tjerë të sigurisë, të cilët do të duhej të përdroreshin për kutinë e votimit, andaj kërkuan ndihmë nga Komisioni Zonal për Administrimin e Zgjedhjeve (KZAZ). Përfaqësuesi i KZAZ u vonua për të ardhur deri në orën 07:30, andaj edhe hapja e vendvotimit ishte vonuar, duke ngritur dyshime në votuesit të cilin prisnin në rend për të votuar. KZAZ ndihmoi në zgjidhjen e problemit dhe vendvotimi u hap rreth orës 08:00, duke mundësuar që votuesit të votojnë.

DnV ka vlerësuar se në këtë dhe disa vendvotime tjera, komisionerët nuk ishin mirë të përgatitur për procesin zgjedhor. Kjo mund të jetë për shkak të mungesave në trajnime që organizohen nga trupat për menaxhimin e zgjedhjeve. Gabime të tilla teknike sikur në shkollën *Jeronim De Rada* mund të kenë pasoja deri në anulimin e rezultateve për atë vendvotim, andaj pjesëmarrja në trajnime kualitative është më se e nevojshme. Ky problem shpeshherë paraqitet edhe në Kosovë, andaj komisionerët që nuk i ndjekin trajnimet, duhet të zëvendësohen me ata që janë të gatshëm ta bëjnë këtë.

## III. Votimi

Në të gjitha vendvotimet e mbuluara nga vëzhguesit e DnV, procesi i votimit ka qenë i rregullt dhe pa ndonjë incident që do të ndikonte në integritetin e procesit të votimit apo rezultateve. Numri i madh i vendvotimeve 5200+ u mundësonte qytetarëve qasje të afërt me kutinë e votimit. Në asnjërën nga vendvotimet në Tiranë apo Fier nuk kishte rend të gjatë të votimit.

Në shumicën e qendrave të votimit kishte qasje për votuesit me nevoja të veçanta. Ata votonin në mënyrë të rregullt pa asistencë. Në disa qendra të votimit, kishte kabina të votimit me karrige, që iu mundësonte personave të me aftësi të kufizuar që të uleshin gjatë mbushjes së

fletëvotimit. Kjo ishte një praktikë e mirë e ndërmarrë nga trupat menaxhuese zgjedhore. Në anën tjetër, përndryshe nga Kosova, votuesit e verbër në Shqipëri nuk kishin fletëvotim taktil apo brail që mundëson votimin e këtyre personave në mënyrë të fshehtë, andaj votonin me asistencë.

Ambienti jashtë qendrave të votimit ishte kryesisht i qetë. Edhe pse lagjet ishin stërmbushur me billbordë, flamuj dhe mjete të tjera të fushatës së subjekteve politike, qendrat e votimit ishin të pastra nga materialet propaganduese. Në qendra të votimit nuk kishte materiale të fushatës, dhe askush nuk tentonte që ta prish heshtjen zgjedhore. Megjithatë, sidomos në qarkun e Fierit, jashtë qendrave të votimit ka pasur grupe militante partiake. Përkundër asaj që vëzhguesit e DnV-së nuk kanë vërejtur që këta persona të kenë ushtruar presion apo kërcënime ndaj vëzhguesve apo votuesve, vetë prania e tyre përreth qendrave të votimit ishte e dyshimtë.

Lista e votuesve ishte e publikuar jashtë qendrës së votimit, dhe gjithashtu kishte një tavolinë ndihmëse që i drejtonte votuesit në vendvotimin e caktuar, edhe pse një gjë e tillë nuk ishte parë në qendrat e qarkut të Fierit. Votuesit së pari e gjenin emrin dhe vendvotimin ku ishin caktuar për të votuar, dhe më pas hynin në vendvotim. Kjo ishte një praktikë e mirë, për të iu shmangur rasteve kur votuesi hyn në vendvotim dhe nuk e gjen emrin e tij apo saj në listën e votuesve.

Procedurat brenda vendvotimit ishin të ngjashme me ato të Kosovës. Tek hyrja e vendvotimit qëndronte njëri nga komisionerët i cili e mbante rendin e votuesve dhe i drejtonte ata për tek komisioneri që bënte identifikimin. Votuesit vazhdonin tek komisioneri me listën e votuesve, ku bëhej identifikimi me kartë të identitetit apo me pasaportë. Më pas, votuesve iu bëhej gishti i madh i dorës me marker të dukshëm, i jepej fletëvotimi i vulosur dhe vazhdonte për në kabinën e votimit. Pas përzgjedhjes së partisë së preferuar nga votuesi, ai/ajo e paloste fletëvotimin në atë mënyrë që të dukeshin vulat në anën e jashtme të fletëvotimit. Çdo votues që nuk e paloste fletëvotimin në mënyrë të rregullt, udhëzohej nga komisionerët që ta bëj atë, në mënyrë që të shihet fletëvotimi i vulosur i vlefshëm. Procedurat e vendvotimit respektoheshin më shumë në Tiranë se sa në Fier.

Komisionerët e vendvotimit ishin të përbërë nga përfaqësues të subjekteve politike. Kryetari dhe Sekretari i vendvotimit ishin përfaqësues të dy partive më të mëdha në Kuvendin e Shqipërisë. Gjatë gjithë procesit të votimit, komisionerët e menaxhuan procesin në mënyrë të rregullt dhe të paanshme. Ata sillleshin mirë me të gjithë votuesit dhe e mbanin rendin dhe qetësinë brenda vendvotimit. Përderisa komisionarët e dy partive kryesore në vend ishin mjaft vigjilent dhe shërbenin si kontrollues të rreptë të njëri tjetrit, e njëjta nuk mund të thuhet edhe për komisionerët e partive tjera politike.

Në të gjitha vendvotimet e mbuluara, kishte një numër të konsiderueshëm të vëzhguesve partiak dhe të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Vëzhguesit partiak mbanin me vete listën e votuesve, dhe regjistronin të gjithë votuesit që kanë marrë pjesë në votime. Ata e bënë këtë për të matur pjesëmarrjen në zgjedhje, mirëpo edhe që të kontaktojnë personat të cilët nuk kanë votuar, që të kërkojnë votën në mbështetje të partisë së tyre.

#### **IV. Mbyllja**

Në ato vendvotime të mbuluara nga vëzhguesit e DnV procesi i mbylljes, edhe pse i ngadalshëm, ishte bërë në mënyrë të rregullt. Kryesuesi dhe Sekretari i vendvotimit dilnin jashtë vendvotimit, për tu siguruar që nuk ka votues të cilët presin në rend për të votuar. Komisionerët votuan në fund të procesit ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore të Shqipërisë, dhe më pas e mbyllën vendvotimin.

Komisionerët filluan të numërojnë me saktësi numrin e nënshkrimeve në listën e votuesve, numrin e fletëvotimeve të dëmtuara dhe numrin e fletëvotimeve të papërdorura. Të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit mund ta vështronin procesin pa penguar. Të dhënat përputheshin, dhe të gjithë komisionerët pajtoheshin unanimisht për të nënshkruar protokollet e nevojshme. Për dallim nga zgjedhjet në Kosovë, protokollet ishin më të thjeshta dhe të shkurtra – por kjo për shkak që në Shqipëri nuk bëhet numërimi i votave në vendvotim, dhe nuk ka votime me kusht.

Pas përfundimit të procesit të mbylljes, komisionerët e kontaktuan KZAZ-në, që të vijnë dhe të bëjnë transportimin e kutive dhe materialeve për në qendrën e numërimit. Gjatë transportit të kutive dhe materialit zgjedhor, prezent në veturë ishin zyrtari i KZAZ, një polic, Kryetari dhe Sekretari i qendrës së votimit. Policia e mbante rendin dhe sigurinë gjatë transportimit të materialeve për në qendër të numërimit.

#### **V. Pranimi i Materialeve në Qendrën e Numërimit**

Pas transportimit të materialeve, pranimi bëhej paralelisht në të gjitha qendrat e numërimit, të cilat ishin të organizuara nga KZAZ-të. Vëzhguesit e DnV e kanë parë pranimin e materialeve në katër qendra të numërimit, dhe kanë konstatuar se pranimi bëhej në mënyrë të paorganizuar dhe jo-efikase.

Numri i madh i veturave që sillnin materialet e votimit në të njëjtën kohë nuk mundësonte qasje në parkingjet e qendrave të votimit. Materialet zgjedhore nxirreshin nga veturat jashtë qendrës, dhe sillleshin deri tek dera e hyrjes, mirëpo prapë mbeteshin jashtë qendrës së numërimit për orë të tëra. Policia nuk e mbante rendin në mënyrë të rregullt, dhe krijohej guzhmë e madhe jashtë qendrës së numërimit, ku kishin qasje jo vetëm vëzhguesit por edhe

qytetarët e rëndomtë dhe militantët partiak. Një rend i tillë i paorganizuar cenon sigurinë e kutive të votimit, të cilat shoqëroheshin nga Kryetari dhe Sekretari i secilit vendvotim. Ata prisnin jashtë qendrës së bashku me materiale zgjedhore, derisa brenda qendrës hynin një nga një për të nënshkruar protokollin e pranimit.

Në shkollën *Vasil Shanto* në Tiranë, bëhej pranimi i materialeve për 111 vendvotime. Pranimi i materialeve shkonte shumë ngadalë, pasi që ishin caktuar vetëm dy tavolina të pranimit nga KZAZ-ja. Edhe pse të gjitha të dhënat gjatë pranimit përputheshin, pranimi në këtë qendër të numërimit u vonua deri në mesnatë (00:00). Në tavolinën e pranimit, shkonin Kryetari, Sekretari si dhe polici për të nënshkruar protokollin.

## **VI. Numërimi**

Numërimi i votave në Shqipëri është një proces unik, pasi që nxjerrja e rezultateve preliminare mund të vonohet 5-7 ditë pas ditës së zgjedhjeve. DnV konsideron se kjo vonesë është e paarsyeshme, sidomos kur dihet që shtetet me më shumë miliona votues i nxjerrin rezultatet brenda natës së zgjedhjeve.

Procedurat e numërimit në Shqipëri ishin shumë të komplikuar dhe të ngadalshme. Ekipet e numërimit përbëheshin nga katër persona. Këto ekipe e hapnin kutinë e votimit, i kthenin përmbys të gjitha fletëvotimet dhe fillonin të numëronin fletëvotimet për të shikuar nëse të gjitha janë të vulosura dhe të vlefshme. Më pas fletëvotimet ktheheshin nga lista e kandidatëve, dhe numëroheshin një nga një. Fletëvotimet gjithashtu skanoheshin dhe shfaqeshin në ekranet afër tavolinave të numërimit, që siguronte një vëzhgim transparent., edhe pse nganjëherë ishte e vështirë të vërehej nëse fletëvotimi ishte i rregullt apo jo.

Prapa ekraneve televizive qëndronin vëzhguesit dhe raportuesit e mediave, të cilët siguronin që secili fletëvotim e reflekton vullnetin e votuesit. Gjatë gjithë procesit të numërimit, prania e vëzhguesve ishte mjaft e madhe, madje as e madhe sa që nuk mund ti akomodonte të gjithë ata vëzhgues që dëshironin të kishin qasje në ekranet televiziv.

Pas mesnatës, qendrat e numërimit u mbyllën për të vazhduar punën të nesërmen. Të nesërmen, në dy qendra të numërimit në Tiranë, ekipet e numërimit nuk kishin ardhur deri në ora 12:00 në mesditë. Vëzhguesit që ishin zgjuar herët në mëngjes prisnin jashtë qendrës së numërimit, pasi që policia nuk i lejonte askujt qasje në qendër deri sa të arrinin ekipet e numërimit. Kjo vonesë e panevojshme ndikonte negativisht në transparencën e procesit të numërimit dhe vonesën në nxjerrjen e rezultateve preliminare. Situata e njëjtë ishte edhe në qendrat e numërimit në Fier, ku vërehej një zvarritje në numërim dhe pushime të shpeshta dhe të gjata të numëruesve.

Përgjatë reformës zgjedhore 2011-2012 në Kosovë, është diskutuar shumë se a është më mirë të bëhet: 1) numërimi në vendvotim; apo 2) numërimi në qendra rajonale apo qendrore. Të dy këto sisteme i kanë përparësitë dhe mangësitë e tyre: e para i nxjerr rezultatet më shpejtë, mirëpo mund të manipulohet më lehtë nëse komisionarët nuk janë në nivel të detyrës si dhe nëse vëzhguesit nuk mund ti mbulojnë të gjitha vendvotimet; ndërsa e dyta i nxjerr rezultatet më ngadalë, mirëpo manipulimi po thuajse është i pamundur për shkak të prezencës së madhe të vëzhguesve. Megjithatë, DnV beson që numërimi duhet të mbetet brenda vendvotimit në Kosovë, për shkak që i përshtatet më shumë situatës elektorale. Ky sistem i nxjerr rezultatet preliminare gjatë natës së zgjedhjeve dhe ul tensionet politike. Për më tepër, një vonesë e rezultateve të zgjedhjeve prej 5-7 ditë do të rriste mosbesimin e votuesve ndaj procesit zgjedhor.

## **VII. Parregullsitë Zgjedhore**

Gjatë ditës së zgjedhjeve, mediat kanë raportuar për incidente dhe parregullsi të ndryshme gjatë procesit zgjedhor në Shqipëri. Vëzhguesit e DnV nuk kanë qenë prezent gjatë këtyre incidenteve, dhe nuk kanë parë ndonjë parregullsi që do të cenonte integritetin e procesit zgjedhor apo te rezultateve.

Vëzhguesit kishin parë raste kur më shumë se një person ishte prapa kabinës së votimit, kur mashkulli e mbushte fletëvotimin e ndonjë femre për të votuar. Kjo tregon që votimi familjar mbetet një dukuri në zgjedhjet e Shqipërisë. DnV gjithashtu kishte parë disa votues duke e fotografuar fletëvotimin. Kishte edhe indikacione të blerjes së votës, pasi që militantë partiak qëndronin jashtë qendrës së votimit.

## **VIII. Përdorimi i teknologjisë së zgjedhjeve**

Njëra prej objektivave kryesore të vëzhgimit të zgjedhjeve në Shqipëri, ka qenë që DnV të bëjë një vlerësim mbi pilot-projektet për përdorimin e teknologjisë zgjedhore në Fier dhe Tiranë. Përgjatë reformës zgjedhore në Shqipëri, ndryshimet në kornizën ligjore e kishin detyruar KQZ-në që në Fier të përdor teknologjinë për numërimin e fletëvotimeve, ndërsa në Tiranë teknologjinë për identifikimin biometrik të votuesve.

Korniza ligjore i kishte ofruar afate të shkurtra kohore KQZ-së për këto projekte të cilat kërkonin përgatitje në procesin e tenderimit, testimet me akterët zgjedhorë dhe implementimin e tyre në terren. KQZ e kishte përzgjedhur një kompani nga Spanja "Indra", që do të ofronte këto teknologji, mirëpo për shkaqe teknike, KQZ vendosi që një javë para ditës së zgjedhjeve të anulojë përdorimin e tyre.

Teknologjia për numërimin e fletëvotimeve do të bënte leximin e fletëvotimeve dhe nxjerrjen e rezultateve përmes skanerëve. Për këtë, KQZ kishte krijuar një fletëvotim të veçantë për

zgjedhje në Fier, që do të mund të lexohej nga këta skanerë. Dy kuti të votimit do të numëroheshin nga skanerët, dhe gjithashtu do të bëhej numërimi në mënyrë manuale që të verifikohesh saktësia e rezultateve në ato kuti. Nëse dallimi në mes të rezultateve të nxjerra nga skanerët dhe rezultateve të nxjerra në mënyrë manuale do të ishte më shumë se 0.5%, atëherë do të pezullohej përdorimi i kësaj teknologjie, në mënyrë që të bëhet numërimi vetëm në mënyrë manuale. KQZ kishte hasur në dy probleme gjatë implementimit të projektit në Fier. Problemi i parë ishte se fletëvotimi ishte më i madh se hapësira të cilët mund ta lexonte teknologjia. Numri i madh i partive të regjistruara (67 emra të partive dhe kandidatësh) për të garuar në zgjedhje e kishte rritur madhësinë e fletëvotimit, përderisa skanerët kishin hapësirë më vogël të leximit – mund të lexonin vetëm 42 emra. Problemi i dytë ishte që skanerët i lexonin fletëvotimet aq ngadalë, sa që numërimi bëhej më shpejtë në mënyrë manuale përmes ekipeve të numërimit.

Projekti i dytë që e kishte pezulluar KQZ-ja ishte përdorimi i teknologjisë për verifikimin biometrik të votuesve. Ky projekt parashihte instalimin e aparaturave në qendra të votimit në Tiranë, që do të mund të verifikonin votuesit përmes leximit të pasaportës apo kartës së identitetit. Edhe me këtë teknologji, ishte paraparë që nëse nuk do të funksiononte identifikimi përmes aparaturës, do të bëhej identifikimi manual i votuesve përmes komisionerëve. Gjatë testimit të kësaj teknologjie, KQZ kishte parë që aparatura mund të nxjerrë një votues që ka votuar, por nuk arrin ta ndalojë atë votues që të votoj në ndonjë qendër tjetër të votimit – e që ishte arsyeja kryesore e përdorimit të kësaj teknologjie. Kjo aparaturë gjithashtu nuk i lexonte pasaportat apo kartat e identitetit të cilat ishin të vjetra apo të dëmtuara.

Sa i përket përdorimit të teknologjisë zgjedhore, rasti i Shqipërisë na mëson disa gjëra që duhet pasur parasysh përgjatë reformës zgjedhore në të ardhmen në Kosovë. E para, nuk duhet të krijohen obligime ligjore për KQZ-në që të përdorë teknologji zgjedhore për identifikim apo numërim të fletëvotimeve, nëse nuk i është dhënë KQZ-së kohë e mjaftueshme për planifikim dhe testime të këtyre teknologjive. E dyta, motivi për përdorimin e teknologjisë nuk duhet të jetë vetëm për të adresuar problemet e parregullsisë zgjedhore, sepse mund të kemi parregullsi dhe nëse e përdorim teknologjinë. E treta, duhet të bëhet një studim fizibiliteti nëse teknologjia është e përshtatshme në kontekstin zgjedhor në Kosovë, duke pasur parasysh mangësitë në listën e votuesve në Kosovë, koston financiare për përdorimin e teknologjisë, nevojën për trajnime të komisionerëve, rryma dhe faktorë të tjerë. E katërta, nëse vendoset të përdoret teknologjia e zgjedhjeve në të ardhmen në Kosovë, gjithsesi duhet të bëhet me një pilot projekt në ndonjë komunë të vogël – dhe jo menjëherë të përdoret në nivel kombëtarë.